



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 7.7.2020

**Lënda:** Bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 7.7.2020, para trupit gjykues, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr.162, datë 19.6.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Manjola Kajana

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5, të Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 303 i Kodit të Procedurës Civile

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të ankimit ndaj vendimit nr. 162, datë 19.6.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Manjola Kajana, Komisioneri Publik vlerëson të ndalet në disa elemente të këtij ankimi, referuar provueshmërisë së tyre, që rezultoi në përfundim të hetimit gjyqësor.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, është një subjekt për të cilin procesi i rivlerësimit u krye me përparësi në kohë për shkak të kërkesës së saj për t’u ngritur në detyrë, si prokurore në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, SPAK.

Nisur nga përmbajtja e hetimit dhe vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për këtë subjekt rivlerësimi, Komisioneri Publik vlerësoi se kishte nevojë për hetim të mëtejshëm kryesisht në lidhje me rrethanat ligjore dhe faktike të përfshirjes së familjes së subjektit të rivlerësimit në listën e qytetarëve që përfitonin kredi me kushte lehtësuese nga ana e Bashkisë së qytetit Fier.

Komisioneri Publik çmon të sjellë në vëmendje faktin se përfitimi i kredive me kushte lehtësuese nga disa funksionarë të organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, gjatë së njëjtës kohë kur po kryheshin hetime nga e njëjta prokurori, për të njëjtin fakt, ndaj funksionarëve të kësaj bashkie, nuk ishte hetuar nga Komisioni në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Manjola Kajana.

Komisioneri Publik ka ardhur në dijëni të kësaj rrethane gjatë shqyrtimit të akteve të një vendimi më të hershëm në kohë, të Komisionit, për një tjetër subjekt rivlerësimi, drejtues në atë kohë i asaj prokurorie.

Në parashtrimet e tij të seancës së datës 6.3.2020, Komisioneri Publik kërkoi çeljen e hetimit gjyqësor për shkaqet e ankimit. Ky trup gjykues e pranoi këtë kërkesë të Komisionerit Publik si të bazuar dhe mbi vendimin e këtij trupi gjyqësor për çeljen e hetimit janë administruar gjatë këtij gjykimi, në cilësinë e provës, një sërë aktesh nga Gjykata pranë Shkallës së Parë Fier, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Bashkia Fier, si dhe nga subjekti i rivlerësimit.

Komisioneri Publik, pasi vlerëson hetimin gjyqësor të kryer gjatë këtij gjykimi si të plotë, në përfundim të tij, vlerëson në mënyrë analitike si vijon:

**1. Lidhur me evidentimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit midis subjektit të rivlerësimit dhe funksionit të magjistratit/prokurorit, në drejtim të përfitimit të një trajtimi preferencial, në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”(të ndryshuar).**

1.1 **Komisioneri Publik**, në parashtrimet e datës 6.3.2020 kërkoi të administrohen:

(i) Dosja gjyqësore penale e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me vendim nr. \*\*\*-2015-\*\*\* (\*\*\*) , datë \*\*\*.5.2015.

(ii) Informacion nga Prokuroria e Përgjithshme, në rast se subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës tetor 2009 - korrik 2013, kur ka shërbyer pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka qenë në cilësinë e prokurorit të ngarkuar për shqyrtimin e materialeve kallëzuese, procedimeve dhe kërkesave për gjykim për procedime penale, ku përfshihet Banka \*\*\*.\*\*\*.

1.2 **Subjekti i rivlerësimit**, ndër të tjera, në parashtrimet e datës 6.3.2020, është shprehur se: *[...]Në korrik të vitit 2012, kohë që përkon me regjistrimin e kallëzimit penal nr.\*\*\*, i mosfilluar më datë 30.7.2012, nga një tjetër prokuror, të përmendur nga Komisioneri në këtë shkak ankimi, unë kam qenë duke ushtruar funksionin e prokurorit në qytetin e Durrësit dhe jo në Prokurorinë e Fierit; Procedimi penal nr.\*\*\*, që ka pasur si objekt hetimi veprimtarinë e punonjësve të Bashkisë Fier, është regjistruar më datë 31.10.2012, ndërkohë që bashkëshorti im aplikimin e kishte bërë që në fillim të muajit tetor të vitit 2012[...]<sup>1</sup>;[...].Në lidhje me konfliktin e interesit, bazuar në këtë pretendim të Komisionerit, kam kërkuar gjithashtu nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier listën e çështjeve penale që kam pasur në hetim apo gjykim gjatë kohës që kam ushtruar funksionin në këtë Prokurori[...].<sup>2</sup>*

1.3 Subjekti i rivlerësimit, sa më sipër, ka kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit që të administrohen në cilësinë e provës, si vijon:

<sup>1</sup> Referohuni faqes 15 -16, të parashtrimeve të subjektit.

<sup>2</sup> Referohuni faqes 20, të parashtrimeve të subjektit.

- (i) Shkresa nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2019, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, e cila informon se: [...]... *për periudhën ku prokurore Manjola Kajana ka ushtruar detyrën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, nuk rezulton që nga ana e prokurores të jenë hetuar kallëzime/ procedime ndaj Bashkisë Fier, si subjekt të cilit i atribuohet vepra penale [...].*
- (ii) Shkresa nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.2.2020, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, e cila informon se: [...]...*nuk rezulton që të ketë hetuar kallëzime /procedime penale me palë (kallëzues apo të kallëzuar, apo persona që u atribuohet vepra penale/persona nën hetim) Bashkia Fier apo punonjës/zzyrtarë të saj, si edhe me palë (kallëzues apo të kallëzuar, apo persona që u atribuohet vepra penale/persona nën hetim) Bankën \*\*\*.\*\*\* sh.a., dega Fier apo punonjës të saj. Bashkëlidhur është përcjellë lista e plotë e të gjitha kallëzimeve/procedimeve penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit për periudhën që ka ushtruar funksionin e prokurores pranë kësaj Prokurorie.*
- (iii) Shkresa nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.2.2020, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, përmes së cilës është përcjellë: (i) një kopje e vendimit të datës 30.7.2012, “Për mosfillimin e procedimit penal”, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, marrë nga prokurore \*\*\*.\*\*\*; (ii) një kopje të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier nr. \*\*\*-2013-\*\*\* (\*\*\*), datë \*\*\*.2.2013, ku ndër të tjera është vendosur prishja e vendimit të datës 30.7.2012, “Për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. \*\*\*/2012”; (iii) kopje të kërkesës për gjykim të procedimit penal nr. \*\*\*/2012, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, nga prokurori \*\*\*.\*\*\*; (iv) kopje e vendimit nr. \*\*\*-2015-\*\*\* (\*\*\*), datë \*\*\*.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.
- 1.4 **Kolegji**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2020, ka përcjellë pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, shkresat kthim përgjigje të administruara nga trupi gjykues në funksion të këtij shkak ankimi dhe hetimit gjyqësor të çështjes, si vijon:
- (i) Shkresa nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.3.2020, e Prokurorisë së Përgjithshme<sup>3</sup>, e cila ndër të tjera, informon se: [...]...*Gjatë periudhës së komandimit të saj, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës nuk ka regjistruar materiale ku përfshihet Banka \*\*\*.\*\*\* të cilat janë trajtuar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Kajana [...].*
- (ii) Shkresa nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.3.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, bashkëlidhur së cilës është dërguar: (i) Dosja penale e procedimit nr. \*\*\*, datë regjistrimi 31.10.2012, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Fier, me të pandehur \*\*\*.\*\*\* e të tjerë (I+II+III volume); (ii) Dosja penale e Gjykatës së Shkallës së Parë, Fier me nr. vendimi \*\*\*, datë \*\*\*.5.2015, në ngarkim të të pandehurit \*\*\*.\*\*\* e të tjerë; (iii) Dosja penale e Gjykatës së Apelit Vlorë, me nr. vendimi \*\*\*, datë \*\*\*.9.2016, në ngarkim të të pandehurit \*\*\*.\*\*\* e të tjerë.

**2. Lidhur me evidentimin e ligjshmërisë së aplikimit të përfutimit të statusit si i pastrehë, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 (të ndryshuar), si shkak i ndërvarur i ankimit me ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit të ushtrimit të detyrës**

<sup>3</sup> Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.3.2020, i ka dërguar informacion Prokurorisë së Përgjithshme në vijim të kërkesës së saj për informacion nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.3.2020.

nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe përfshirjen e bashkëshortit të saj në listën e subjekteve përfituese të kredisë me kushte lehtësuese.

2.1 **Komisioneri Publik**, në parashtrimet e datës 6.3.2020, lidhur me këtë shkak ankimi, ka kërkuar të administrohet:

(i) *Praktika e plotë dokumentare e aplikimit të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit pranë Bashkisë Fier, në vlerësim të së cilës, me vendimin nr. 46, datë 30.10.2012, të Këshillit Bashkiak Fier, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit u miratua të jetë pjesë në listën emërore të familjeve të pastreha që përfitojnë kredi lehtësuese.*

2.2 **Subjekti i rivlerësimit**, lidhur me këtë shkak ankimi, ndër të tjera, në parashtrimet e datës 6.3.2020, është shprehur se: [...]...sqarojmë se i jemi drejtuar me një kërkesë Drejtorisë së Strehimit pranë Ministrisë së Financave, duke i vënë në dispozicion edhe planimetrinë e banesës së përfituar nëpërmjet privatizimit në Durrës, për një sqarim të Aktit normativ, mbi bazën e të cilit aplikohet sipërfaqja minimale për banim...[...]<sup>4</sup> [...]kemi kërkuar të na vënë në dispozicion një kopje të praktikës së aplikimit dhe nga përgjigjja që kemi marrë nga Bashkia Fier, daton \*\*\*.5.2019, me shkresën e saj, përveçse konfirmojnë faktin se bashkëshorti im, \*\*\*.\*\*\*, nuk është përfitues i kredisë me kritere lehtësuese, të subvencionuar nga shteti, por njëkohësisht Bashkia Fier na ka vënë në dispozicion VKB-në me nr. 46, datë 30.10.2012, si dhe listën e personave që kanë përfituar nga Programet [...].

2.3 Subjekti i rivlerësimit, sa më sipër, ka kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit që të administrohen në cilësinë e provës, si vijon:

(i) Shkresë nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2020, e Ministrisë së Financave dhe e Ekonomisë, Mbi kërkesën e ardhur për sqarim mbi ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, referuar së cilës Drejtoria e Strehimit pranë kësaj Ministrie, në përgjigje të kërkesës së z. \*\*\*.\*\*\*, ka referuar se:[...] Sipas VKM-së nr.567, datë 6.12.1993, “sipërfaqe e banimit” përbëhet nga shuma e sipërfaqeve të hapësirave ku kryhen aktivitete të pushimit aktiv e pasiv dhe përfshin sipërfaqet e dhomës (dhomave) të fjetjes dhe të dhomës së ndenjes. Mbështetur në VKM-në nr.814, datë 3.12.2004, sipas tabelës bashkëlidhur, norma minimale e strehimit për një familje me strukturë 3 persona të rritur është 27.5m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, ndërkohë që sipas informacionit të dhënë ju keni qenë bashkëpronar i një pasurie që shërben për banim, me një sipërfaqe banimi prej 17 m<sup>2</sup>[...].

(ii) Kërkesë e z. \*\*\*.\*\*\*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.5.2019, drejtuar Bashkisë Fier, referuar së cilës ka kërkuar vërtetim në lidhje me mospërfitimin e kredisë sipas VKB nr. 46, datë 30.10.2012, si dhe kopjen e dokumentacionit të paraqitur nga ana e tij pranë Bashkisë.

(iii) Kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.5.2019, e Bashkisë Fier, drejtuar z. Kajana, bashkëlidhur së cilës është vënë në dispozicion një kopje e Vendimit të Këshillit të Bashkisë Fier nr. 46, datë 30.10.2012, “Për miratimin e listës me familjet e pastreha që do të përfitojnë nga program social të kredisë së lehtësuar nga shteti për blerjen e

---

<sup>4</sup> Referohuni prg. 3, faqe 5.

*banesave me kosto të ulët*”, listë në të cilën bashkëshorti i subjektit figuron i listuar si përfitues nga ky vendim, si dhe një kopje e listës së familjeve përfituese në zbatim të këtij programi, në të cilën bashkëshorti nuk figuron përfitues.

(iv) Kërkesë e z. \*\*\*.\*\*, nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.2.2020, drejtuar Bashkisë Fier, sipas së cilës ka kërkuar kopje të dokumentacionit të kërkuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.5.2019, si dhe kopje të dokumentacionit të paraqitur nga ana e tij në Bashki, në lidhje me aplikimin për kredi.

(v) Kthim përgjigje nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.3.2020, e Bashkisë Fier, drejtuar z. Kajana, bashkëlidhur së cilës është rivënë në dispozicion dokumentacioni i përcjellë në kthim-përgjigjen nr. \*\*\*, datë \*\*\*.5.2019, të Bashkisë Fier.

2.4 **Kolegji**, duke hetuar këtë shkak ankimi, në përgjigje të kërkesës për informacion drejtuar Bashkisë Fier, për praktikën e plotë dokumentare të aplikimit të z. \*\*\*.\*\*, ka administruar:

(i) Shkresë nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.4.2020, të Bashkisë Fier (nr. \*\*\* prot., KPA, datë \*\*\*.5.2020), bashkëlidhur së cilës është përcjellë: (i.1) Vendimi nr. 46, datë 30.10.2012, “Për miratimin e listës emërore të kredisë”, i Këshillit të Bashkisë Fier, bashkëlidhur lista emërore e familjeve të pastreha që do t’u përcillen institucioneve përkatëse për të përfituar kredi me kushte lehtësuese;

(ii) Lista e Entit Kombëtar të Banesave për Bashkinë Fier e familjeve të pastreha, që kanë përfituar nga programi social i kredisë së lehtësuar nga shteti për blerjen e banesave me kosto të ulët, ku bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk rezulton si përfitues gjatë ekzekutimit të programit;

(iii) Shkresë nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.3.2020, me lëndë: “Kthim përgjigje”, drejtuar z. \*\*\*.\*\*.

**3. Lidhur me evidentimin e mungesës së hetimit mbi çështje të tjera të lidhura me burimet e ligjshme të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për krijimin e pasurisë apartament 110 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë, për një vlerë negative prej rreth 115.000 lekë**

3.1 **Komisioneri Publik**, në parashtrimet e datës 6.3.2020, ka kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit analizimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për të mbuluar me burime të ligjshme kursimet që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë.

3.2 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, në parashtrimet e datës 6.3.2020, lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ka deklaruar se: [...] Referuar kontratës individuale të punësimit me këtë shoqëri, në kushtet e pagesës është parashikuar detyrim i punëdhënësit për të derdhur në llogari të punëmarrësit kuotën e përcaktuar sipas ligjit në fuqi për tatimet dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore [...].

3.3 **Subjekti i rivlerësimit**, sa më sipër, ka kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit që të administrohen në cilësinë e provës, si vijon:

(i) Shkresa nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.2.2020, e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., e cila informon mbi detajet e përlllogaritjes mbi dy urdhërpagesat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit në

Komision gjatë hetimit administrativ, për përlllogaritjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga punësimi i shtetasit z. \*\*\*.\*\*\*;

(ii) Shkresa nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.3.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër, e cila informon se, bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 24, nuk mund të jepet informacion tatimor lidhur me subjektet tatimpaguese të administruara nga administrata tatimore.

3.4 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, në parashtrimet e datës 6.3.2020, lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar nga Komisioneri Publik, ka pretenduar se: [...] në përlllogaritje nuk janë përfshirë disa kursime në cash në banesë nga babai i bashkëshortit, ...të cilat i janë dhënë bashkëshortit të subjektit në cash në fillim të muajit janar 2011 dhe janë depozituar në bankë [...]. Subjekti i rivlerësimit, duke pretenduar për ekonomi të përbashkët familjare ka riparqitur dokumentacion mbi të ardhurat e vjehrrit të saj dhe lëvizjet e llogarisë bankare të tij pranë \*\*\* Bank sh.a.<sup>5</sup>

3.5 **Kolegji**, gjatë hetimit të çështjes për këtë shkak hetimi, ka administruar:

(i) Shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.3.2020, të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, bashkëlidhur së cilës është përcjellë ekstrakti historik i punësimit për z. \*\*\*.\*\*\*, ku pasqyrohen subjektet ku ky shtetas ka qenë dhe është i deklaruar për efekt të sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Shtetasi Kajana nuk ka qenë i deklaruar pranë subjektit “\*\*\*\*” sh.p.k.;

(ii) Shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.4.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër, e cila ka sqaruar se, *meqë DRT Dibër nuk disponon informacionin e detajuar për pagesat e subjekteve që janë punësuar apo kanë kontrata shërbimi lidhur me tatimin në burim*, i është drejtuar subjektit “\*\*\*\*” sh.p.k. për dhënie informacioni të detajuar;

(iii) Shkresën e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., datë \*\*\*.3.2020, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër, në përgjigje të kërkesës së DRT-së Dibër, mbi kërkesën për informacion për subjektin \*\*\*.\*\*\*, në të cilën, ndër të tjera, shprehen se: *meqenëse për subjektin, z. \*\*\*.\*\*\*, jemi gjendur përballë një gabimi njerëzor për periudhën e punësimit pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., janë paraqitur në mënyre tabelare datat e pagesave në bankë, shumat e pagesave neto, bruto, përqindja dhe shuma e tatimit në burim, të kryer me vonesë.*

---

<sup>5</sup> Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetim lëshuar nga ZVA Durrës, “Për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare”, për z. \*\*\*.\*\*\*, për periudhën 2008-2014, dhe lëvizjet e llogarisë bankare të tij pranë \*\*\* Bank sh.a., për të njëjtën periudhë.

#### 4. KONKLUZIONE

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

4.1 Komisioneri Publik detyrohet që kërkimet e tij procedurale në procesin e rivlerësimit t'i bazojë në provat dhe faktet, që administrohen gjate hetimit administrativ të Komisionit dhe hetimit gjyqësor të Kolegjit.

4.2 Nisur nga ky detyrim, Komisioneri Publik konstaton se aktet e administruara nga ky trup gjykues përmbushën nevojat për hetim të mëtejshëm mbi verifikimin e situatës juridike të pahetuar, për të identifikuar nëse subjekti i rivlerësimit ka kryer ose jo veprime procedurale hetimore, në drejtim të evidentimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit midis subjektit të rivlerësimit dhe funksionit të magjistratit/prokurorit, cenimit të etikës profesionale.

4.3 Vetë subjekti i rivlerësimit e ka konstatuar rëndësinë e këtij episodi për vijimin e karrierës së saj profesionale. Në parashtrimet e saj, gjatë seancës së datës 6.3.2020, subjekti i rivlerësimit i parashtrori këtij trupi gjykues, në reference të shkaqeve të ankimit, se edhe pse Komisioni nuk e kishte hetuar këtë çështje, ajo vetë kishte administruar shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2019, në Prokurorinë pranë Gjykatës së shkallës së parë Fier, për të vërtetuar mospërfshirjen e saj në hetimin e këtij procedimi penal, por duke mos e dorëzuar këtë akt, në mungesë të kalimit të barrës së provës nga ana e Komisionit.

4.4 Komisioneri Publik, në referencë të këtij shkakut parësor të ankimit, konstaton se aktet e dosjes gjyqësore penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, vendimi nr. \*\*\*, datë \*\*\*.5.2015, që u administruan gjatë hetimit të kryer në këtë gjykim, janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, nuk provohet të ketë qenë në kushtet e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës së magjistratit prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, gjatë periudhës që zgjatën hetimet 2012-2014, duke mos cenuar etikën profesionale në kryerjen e detyrës.

4.5 Ky përfundim bazohet në verifikimin e akteve të dosjes gjyqësore të administruar gjatë gjykimit nga ky trup gjykues, prej nga prokurorja Manjola Kajana nuk rezulton të ketë kryer ndonjë veprim procedural në lidhje me hetimin e zyrtarëve të Bashkisë Fier, si dhe nuk ka mbajtur detyrën e prokurorit drejtues/më të lartë, teksa bashkëshorti i saj listohej për të përfituar nga kjo Bashki një kredi me kushte lehtësuese për familjet e pastreha.

4.6 Në lidhje me shkaqet e tjera të këtij ankimi, plotësimi i kriterëve të aplikimit dhe pamjaftueshmëria financiare në vlerën 115.000 lekë, si të ndërvarura me shkakun parësor të tij, që lidhej me etikën dhe rivlerësimin profesional të magjistratit (*neni 61/4 i ligjit nr.84/2016*) të analizuar më lart, në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, edhe pas hetimit të kryer nga ky kolegji, nuk rezulton se provohen të jenë të tillë, që të shërbejnë si shkaqe për marrjen e masës së shkarkimit.

4.7 Të pabazuara rezultojnë në këtë gjykim edhe pretendimet e ngritura pranë Kolegjit dhe nga ana e denoncuesve \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, për veprime të subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me ligjin. Faktet e pretenduara nga ana e tyre nuk gjejnë mbështetje në situatën ligjore të trajtuar nga ana e subjektit të rivlerësimit në secilin rast.

4.8 Në vijim të këtyre bisedimeve përfundimtare, vlerësoj të nënvizoj se Komisioneri Publik në procesin e rivlerësimit nuk është thjesht një subjekt procedural. Komisioneri Publik përfaqëson interesin publik në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

4.9 Në këtë cilësi, dua të nënvizoj se në çdo rast, konfirmimi në detyrë i një magjistrati, për më tepër, përpara procedurës së ngritjes në detyrë si prokuror në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, SPAK, parë në raport me rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, duhet të konsiderohet një moment shumë i rëndësishëm ligjor, etik, profesional dhe reflektimi njerëzor. Komisioneri Publik shpreson që kjo të ndodhë edhe në rastin e prokurores Manjola Kajana.

4.10 Përfundimisht, mbështetur në parashikimet e nenit F, pika 7 e aneksit të Kushtetutës, nenit 65, nenit 66, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik kërkon lënien në fuqi të vendimit nr.162, datë 19.6.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Manjola Kajana.

**KOMISIONERI PUBLIK**  
**Florian BALLHYSA**